



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË



Nr.Regj.Them 1670

NR 2229 VENDIMI
DT 24.06.2020

Vendim

Për Përfundimin e Proçedurës së Falimentimit të Shoqërisë “ITSGA” sh.a, Shoqëri në Falimentim

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej :

NERITAN CENA – GJYQTAR

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Besa Lleshi**, sot në Tiranë më datë 24.06.2020 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore kërkesën që i përket :

KËRKUESE: Administratorja e Falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a, znj.Shpresa Breçani e datëlindjes 20.03.1964, me nr. Personal G 45320378 H, e liçencuar nga Ministria e Drejtësisë me liçencën Nr. 09, datë 16.10.2012 me NIPT K71529023 K, me adresë : Rruga “Panorama”(ish Rruga Jordan Misja), Pallati Sara – El, kati i dytë. Celular 0682094103.

OBJEKTI: Miratimi i Raportit të Administratores së Falimentimit të datës 09.03.2020 për Mbylljen e Proçedurës së Falimentimit të Shoqërisë “ITSGA” sh.a shoqëri në falimentim.

BAZA LIGJORE : Ligji nr. 110/2016 “Për Falimentimin”. VKM nr. 733, datë 13.11.2019 “Për Miratimin e Standarteve Kombëtare të Administrimit të Masës së Falimentimit”

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga ana e Administratores së Falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a, dëgjoi këtë të fundit në seancën gjyqësore të datës 24.06.2020, shqyrtoi edhe raportin e përgatitur nga ana e administratores së falimentimit të emërtuar : “Për Mbylljen e Proçedurës së Falimentimit të Shoqërisë “ITSGA” sh.a, Shoqëri në Falimentim”, dëgjoi edhe përfaqësuesit e kreditorëve të shoqërisë “ITSGA” sh.a, të cilët ishin dakord me përfundimin e proçedurës së falimentimit të Shoqërisë “ITSGA” sh.a, shqyrtoi edhe Proces – Verbalin e datës 09.03.2020 të mbajtur nga ana e Komitetit të Kreditorëve të Shoqërisë “ITSGA” sh.a, Shoqëri në Falimentim lidhur me mbylljen e proçedurës së falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a.



VËREN

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e datës 05.04.2019 ndër të tjera ka vendosur:

“ – Pranimin e kërkesës së kërkuetit, Shoqëria “ITSGA” sh.a

- Hapjen më datë 05.04.2019 të procedurës së falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a me administrator z. Mateos Zoto, me veprimtari “organizim lojrash fati”, me NUIS K 51313001 H dhe me seli në adresën Rruga e Dibrës, Pallat i ri 5 kate, kati i dytë përbri Medresesë, ngjitur me Klinikën Ortodokse, Tiranë, Shqipëri.

- Caktimin s'i administrator të falimentimit për shoqërinë “ITSGA” sh.a të znj. Shpresa Breçani e datëlindjes 20.03.1964, më nr.Personal G45320378H e liçencuar nga Ministria e Drejtësisë me liçencën Nr. 09, datë 16.10.2012, me NIPT K71529023 K, me Adresë : Rruga Panorama (ish Rruga Jordan Misja), pall Sara – El, kati i dytë pranë Hipotekës Tiranë dhe me Cel : 0682094103.

.....

- Caktimin e një komiteti të përkohshëm të kreditorëve në përputhje me nenin 29 pika dh) të ligjit nr. 110/2016 “Për falimentin” duke u caktuar si anëtarë të këtij komiteti Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë si kreditor të pasiguruar dhe si kreditor i preferuar punonjësi ndaj të cilit kërkueti ka detyrimin më të lartë.

.....etj”.

1.1 Vendimi gjyqësor i sipërcituar rezulton që të ketë marrë formë të prerë për shkak se nuk është ushtruar ankim nga palët ndërgjyqëse.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e datës 13.01.2020 rezulton që në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 110/2016 “Për Falimentimin” të ketë vendosur :

“- Pranimin e kërkesës së administratores së falimentit të shoqërisë “ITSGA” sh.a.

- Miratimin e Komitetit të Ri të Kreditorëve të shoqërisë në falimentim “ITSGA” sh.a të përbërë nga :

i. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me përfaqësuese znj. Enkeleda Halilaj (Nasi) ;

ii. Aksionari i shoqërisë “ITSGA” SH.A me përfaqësues z. Genci Germau;

iii. Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë me përfaqësuese znj. Alma Ballçaj;

iv. Kreditorët e shoqërisë “ITSGA” sh.a me përfaqësues z. Fatjon Qerimi;

v. Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit, me përfaqësuese znj Arjona Bello”.

3. Në vijim të veprimtarisë së saj administratorja e falimentit të shoqërisë “ITSGA” sh.a rezulton që në përputhje me përcaktimet e ligjit kuadër nr. 110/2016 “Për Falimentimin” dhe në përputhje edhe me përcaktimet e VKM nr. 733, datë 13.11.2019 “Për Miratimin e Standarteve Kombëtare të Administrimit të Masës së Falimentit” të ketë hartuar raportin përkatës për shpërndarjen e masës së falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a, shoqëri në falimentin duke përcaktuar në mënyrë të detajuar se si do shpërndahet masa e falimentimit e cila rezulton të jetë në shumën 12,100,000 (dymbëdhjetë milionë e njëqind mijë) Lekë.

4. Referuar përmbajtjes së Proçes – Verbalit të datës 18.02.2020 rezulton që raporti i hartuar nga ana e administratores së falimentit të shoqërisë “ITSGA” sh.a të jetë miratuar nga ana e Komitetit të Kreditorëve ku dhe rezulton që të jetë përcaktuar shprehimisht se :
“Përfaqësuesja e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, përfaqësuesi i aksionerëve të



shoqërisë "ITSGA" sh.a, përfaqësuesja e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë, përfaqësuesi i kreditorëve të shoqërisë "ITSGA" sh.a, s'i dhe përfaqësuesja e Autoritetit të Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit janë unanimisht dakord me raportin e Administratores së Falimentimit për shpërndarjen e masës së falimentimit dhe mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë "ITSGA" sh.a, shoqëri në falimentim".

5. Referuar përmbajtjes së raportit të realizuar nga ana e administratores së Falimentimit të shoqërisë "ITSGA" sh.a të emërtuar: "Mbi Shpërndarjen e Masës së Falimentimit dhe Mbylljen e Procedurës së Falimentimit të Shoqërisë "ITSGA" sh.a, Shoqëri në Falimentim" rezulton që ky raport përse i përket mënyrës së shpërndarjes së masës së falimentimit të shoqërisë së sipërcituar të jetë hartuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit kuadër nr. 110/2016 "Për Falimentimin", s'i dhe në përputhje edhe me përcaktimet e VKM nr. 733, datë 13.11.2019 "Për Miratimin e Standarteve Kombëtare të Administrimit të Masës së Falimentit" dhe konkretisht në përputhje me nenet 48, 49, 50 dhe 53 të ligjit të sipërcituar, dispozita këto në të cilat rezulton që të jenë përcaktuar ndër të tjera edhe caktimi i shpërblimit për administratoren e falimentimit dhe anëtarët e Komitetit të Kreditorëve.

6. Me vendimin e datës 26.02.2020 nga ana e Gjykatës rezulton që të jetë vendosur:

- Pranimin e kërkesës së Administratores së Falimentimit të shoqërisë "ITSGA" sh.a

- Miratimin e shpërndarjes së masës së falimentimit të Shoqërisë "ITSGA" sh.a, Shoqëri në Falimentim sipas raportit të datës 18.02.2020 të realizuar nga ana e administratores së falimentimit të shoqërisë "ITSGA" sh.a, znj. Shpresa Breçani, s'i dhe miratimin edhe të masës së shpërblimit të administratores së falimentimit të shoqërisë "ITSGA" sh.a, znj. Shpresa Breçani në shumën e përcaktuar në raport, si dhe miratimin dhe të shpërblimit të Komitetit të Kreditorëve të Shoqërisë në Falimentim "ITSGA" sh.a në shumën e përcaktuar në raport, si dhe miratimin edhe të shpenzimeve të procedurës së falimentimit të shoqërisë "ITSGA" sh.a.

7. Pas vendimarrjes së sipërcituar nga ana e administratores së falimentimit të shoqërisë "ITSGA" sh.a rezulton që të jetë proceduar me shpërndarjen e masës së falimentimit duke shlyer për këtë qëllim shpenzimet e procedurës së falimentimit, shpërblimin e administratores së falimentimit, shpenzimet e anëtarëve të komitetit të kreditorëve, pagesën e kreditorëve të falimentimit.

8. Pas përfundimit të shpërndarjes së masës së falimentimit nga ana e administratores së falimentimit në kushtet ku është bërë shpërndarja e masës së falimentimit janë arkëtuar të gjithë debitorët dhe shoqëria nuk disponon më pasuri të tjera për shitje anë për arkëtimin e shumave të tjera rezulton që të jetë kërkuar përfundimi i procedurës së falimentimit të shoqërisë "ITSGA" sh.a, shoqëri në falimentim.

Referuar përmbajtjes së kërkesës së paraqitur nga administratorja e Falimentimit të shoqërisë "ITSGA" sh.a nga ana e gjykatës do të merret në shqyrtim fakti nëse ekzistojnë apo jo kushtet për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë "ITSGA" sh.a, shoqëri në falimentim, referuar për këtë qëllim përcaktimeve të nenit 153 të Ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016 "Për Falimentimin", dispozitë kjo e emërtuar: "**Përfundimi i procedurës së falimentimit**".

Në dispozitën e sipërcituar rezulton që të parashikohet shprehimisht:

"1. Pasi ka përfunduar shpërndarja përfundimtare, gjykata e falimentimit vendos përfundimin e procedurës së falimentimit.

2. Paga e plotë për të gjithë kreditorët e falimentimit në çdo fazë të procedurës është një shkak për përfundimin e procedurës.



3. Vendimi i gjykatës dhe arsyet e përfundimit shpallen publikisht.

4. Në rastin e personave juridikë, kur të gjithë kreditorët shlyhen plotësisht, atëherë shpërndarja e plotë e të ardhurave pas likuidimit të pasurisë sjell prishjen e personit juridik. Në këtë rast, administratori i falimentimit dërgon vendimin e gjykatës së falimentimit në regjistrat përkatës, në mënyrë që të fshijë debitorin nga këto regjistra.

5. Në rastin e personave fizikë, zbatohen dispozitat e pjesës së shtatë të këtij ligji”.

Në rastin konkret sikurse rezultojnë që të jetë përcaktuar edhe në kërkesën e paraqitur nga ana e administratores së falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a, shoqëri në falimentim rezultojnë që nga ana e kësaj të fundit të jetë përfunduar shpërndarja e masës së falimentimit, si dhe rezultojnë që të jenë arkëtuar të gjithë debitorët e shoqërisë “ITSGA” sh.a, si dhe kjo e fundit nuk rezultojnë që të disponojë pasuri të tjera për shitje, si dhe nuk rezultojnë të ketë shuma të tjera për të arkëtuar.

Në rrethanat e sipërcituara arrihet në përfundimin se në përputhje me përcaktimet e nenit nenit 153 pika 1 të Ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016 “Për Falimentimin” plotësohen kushtet për ta deklaruar të mbyllur procedurën e falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a, shoqëri në falimentim për shkak se nga ana e administratores së falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a, shoqëri në falimentim rezultojnë që të ketë përfunduar shpërndarja përfundimtare e masës së falimentit.

Në arrijtjen e një përfundimi të tillë gjykata vlerëson të mbajë parasysh edhe faktin se Komiteti i Kreditorëve rezultojnë që të ketë qenë unanimisht dakord me kërkesën e administratores së falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a shoqëri në falimentim duke nënshkruar për këtë qëllim edhe proces – verbalin përkatës që mban datën 09.03.2020.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në zbatim të neneve 126, 306 – 310 të Kodit të Proçedurës Civile, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 110/2016 “Për Falimentimin”, s’i dhe në zbatim të VKM nr. 733, datë 13.11.2019 “Për Miratimin e Standarteve Kombëtare të Administrimit të Masës së Falimentit”

VENDOSI

- Përfundimin e Proçedurës së Falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a.
- Urdhërohet botimi i një kopje të shkurtuar të këtij vendimi për përfundimin e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a, në faqen elektronike të Gjykatës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.
- Urdhërohet administratorja e falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a, znj. Shpresa Breçani që të depozitojë vendimin e përfundimit të proçedurës së falimentimit të shoqërisë “ITSGA” sh.a në regjistrat përkatës me qëllim fshirjen si debitorë të shoqërisë “ITSGA” sh.a nga këto regjistra.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, afat i cili për të gjitha palët e proçedurës së falimentimit dhe konkretisht si për Drejtorinë Rajoanle Tatimore Tiranë. aksionarët e shoqërisë “ITSGA” sh.a



me përfaqësues z. Genci Germau, Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë, Kreditorët e shoqërisë "ITSGA" sh.a me përfaqësues z. Fatjon Qerimi, si dhe Autoritetin e Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

- U shpall në Tiranë sot më datë 24.06.2020.

SEKRETARE

BESA LLESHI

GJYQTAR

NERITAN CENA



Vendimi mori forme të prera pasi nuk u ankimua me dt 30.09 2020
Tirane me dt 26.10 2020

K / SEKRETARE
VALBONA SABIKU



2229 / 2020

